Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-056 PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 08/L-249[1]

DRAFT LAW ON AMENDING AND SUPPLEMENTING LAW NO. 06/L-056 ON KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL, AMENDED AND SUPPLEMENTED BY LAW NO. 08/L-249[2]

NACRT ZAKONA O DOPUNI I IZMENI ZAKONA BR. 06/L-056 O TUŽILAČKOM SAVETU KOSOVA, IZMENJEN I DOPUNJEN ZAKONIMA BR. 08/L-249[3]

---

[1] Projektligj për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokuroria të Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.08/L-249, miratuar në mbledhjen e 2-të, të Qeverisë së Republikes së Kosovës me Vendimin Nr.05/02, të datës 25.09.2026.

[2] Draft Law on Amending and Supplementing Law No.06/L-056 on Kosovo Prosecutorial Council, Amended and Supplemented by Law No.08/L-249, has been approved in the 2-th Meeting of the Govermment of Republic of Kosovo, with the Decision No.05/02, date 25.09.2026.

[3] Nacrt Zakona o Dopuni i Izmeni Zakona Br.06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, Izmenjen i Dopunjen Zakonima Br.08/L-249,Usvojeno je na 2. sednici Vlada Republike Kosovo Odlukom br.05/02, dana 25.09.2026.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,	**Assembly of the Republic of Kosovo,**	**Skupština Republike Kosova,**
Duke u mbështetur në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,	Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,	Na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosovo,
Miraton:	Adopts:	Usvaja:
LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-056 PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 08/L-249	**LAW ON AMENDING AND SUPPLEMENTING LAW NO. 06/L-056 ON KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL, AMENDED AND SUPPLEMENTED BY LAW NO. 08/L-249**	**ZAKONA O DOPUNI I IZMENI ZAKONA BR. 06/L-056 O TUŽILAČKOM SAVETU KOSOVA, IZMENJEN I DOPUNJEN ZAKONIMA BR. 08/L-249**
Neni 1 **Qëllimi**	**Article 1** **Purpose**	**Član 1** **Svrha**
Qëllimi i këtij Ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji bazik), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.08/L-249.	The purpose of this Law shall be to amend and supplement Law No. 06/L-056 on Kosovo Prosecutorial Council (hereinafter: the Basic Law), amended and supplemented by Law No. 08/L-249.	Svrha ovog zakona je izmena i dopuna Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova (u daljem tekstu: Osnovni zakon), izmenjen i dopunjen Zakonima Br. 08/L-249.
Neni 2	**Article 2**	**Član 2**
Në nenin 10, paragrafi 10, të Ligjit bazik fjalët "komisionit përkatës ose" fshihen.	In Article 10, paragraph: 10 of the Basic Law the words "the relevant commission or" shall be deleted.	U članu 10, stavu 10 Osnovnog zakona, reči "relevantne komisije ili" se brišu.
Neni 3	**Article 3**	**Član 3**

Neni 10/A, paragrafi 12 i Ligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, riformulohet si në vijim: "12.Organizimi i votimit bëhet në konferencën e përgjithshme të të gjithë prokurorëve të shtetit, e cila mbahet në baza vjetore ose sipas rastit. Secili prokuror voton për deri në tre (3) kandidatë për një (1) pozitë të shpallur të anëtarit prokuror në Këshill. Në rastet kur numri i kandidatëve është më i vogël se numri i votave të mundshme, votimi përshtatet proporcionalisht. Votimi zhvillohet në mënyrë të fshehtë".	Article 10/A, paragraph 12 of Law No. 08/L-249 on amending and supplementing Law No. 06/L-056 on the Kosovo Prosecutorial Council, shall be reformulated as follows: "12. Voting shall be conducted at the general conference of all state prosecutors, which shall be held on an annual basis or as per case. Each prosecutor shall vote for up to three (3) candidates for one (1) announced position of prosecutor member in the Council. In cases where the number of candidates is less than the number of possible votes, the voting shall be adjusted proportionally. The voting shall be conducted by secret ballot."	Član 10/A, stav 12 Zakona br. 08/L-249 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova, preformuliše se i glasi: "12. Glasanje se organizuje na opštem kolegijumu svih državnih tužilaca, koji se održava na godišnjoj osnovi ili zavisno od slučaja. Svaki tužilac glasa za najviše tri (3) kandidata za jedno (1) objavljeno mesto člana tužioca u Savetu. U slučajevima kada je broj kandidata manji od broja mogućih glasova, glasanje se srazmerno prilagođava. Glasanje se održava tajno."
Neni 4	**Article 4**	**Član 4**
1.Pas paragrafit 3 të nenit 22 të Ligjit bazik, shtohet paragraf i ri 3.a., si në vijim: "3.a. Kufizimi i mandatit nga paragrafi 3 i këtij neni zbatohet vetëm për nivelin e njëjtë të prokurorisë".	1.After paragraph 3 of Article 22, a new paragraph 3.a. shall be added as follows: "3.a. The limitation of the mandate from paragraph 3 of this Article shall apply only to the same level of the prosecution office"**.**	1. Posle stava 3 člana 22, dodaje se novi stav 3.a, koji glasi: "3.a. Ograničenje mandata iz stava 3 ovog člana primenjuje se samo za isti nivo tužilaštva".
Neni 5	**Article 5**	**Član 5**
1. Në nenin 13 të Ligjit bazik, pas paragrafit 3, nënparagrafit 3.1 shtohet nën-paragrafi i ri si në vijim:	1. In Article 13 of the basic law, after paragraph 3, sub-paragraph 3.1, a new sub-paragraph is added as follows:	1. U članu 13 osnovnog zakona, posle stava 3, podstav 3.1 dodaje se novi podstav kako sledi:

"3.1.a. i shqiptohet masë disiplinore e shkarkimit për shkelje të rëndë disiplinore, në pajtim me ligjin".	"3.1.a. a disciplinary measure of dismissal shall be imposed for a serious disciplinary violation, in accordance with the law."	"3.1.a. izriče se disciplinska mera razrešenja za težu disciplinsku povredu, u skladu sa zakonom."
Neni 6	**Article 6**	**Član 6**
Pas nenit 13 të Ligjit bazik, shtohet një nen i ri 13/A, si në vijim:	After Article 13 of the basic Law, a new Article 13/A shall be added as follows:	Posle člana 13 osnovnog zakona dodaje se novi član 13/A, koji glasi:
" **Neni 13/A** **Shkeljet disiplinore**	" **Article 13/A** **Disciplinary Violations**	" **Član 13/A** **Disciplinske povrede**
1. Shkeljet disiplinore për anëtarët e Këshillit ndahen në shkelje të lehta disiplinore dhe shkelje të rënda disiplinore.	1. Disciplinary violations for members of the Council are divided into minor disciplinary violations and serious disciplinary violations.	1. Disciplinske povrede članova Saveta dele se na lakše disciplinske povrede i teže disciplinske povrede.
2. Anëtari i Këshillit kryen shkelje të lehtë disiplinore nëse:	2. A member of the Council commits a minor disciplinary violation if:	2. Član Saveta čini lakšu disciplinsku povredu ako:
2.1. në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj;	2.1. he/she continuously fails to perform official duties on time, as required by law;	2.1. kontinuirano ne izvršava službene dužnosti na vreme, kako je propisano zakonom;
2.2. nuk i respekton rregullat e brendshme të punës së Këshillit ose të komisioneve të tij;	2.2. he/she does not respect the internal rules of procedure of the Council or its committees;	2.2. ne poštuje unutrašnja pravila rada Saveta ili njegovih komisija;
2.3. përfshihet në çfarëdo komunikimi *ex-parte* me palët e paautorizuara lidhur me punën e Këshillit;	2.3. he/she engages in any ex parte communication with unauthorized parties regarding the work of the Council;	2.3. se upušta u bilo kakvu ex parte komunikaciju sa neovlašćenim licima u vezi sa radom Saveta;

2.4. përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjyqësorit ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.	2.4. he/she engages in conduct, whether on duty or in private, that harms the reputation of the judiciary or may undermine public confidence in the impartiality or credibility of the judiciary.	2.4. se upušta u ponašanje, bilo na dužnosti ili privatno, koje šteti ugledu pravosuđa ili može narušiti poverenje javnosti u nepristrasnost ili kredibilitet pravosuđa.
3. Anëtari i Këshillit kryen shkelje të rëndë disiplinore nëse:	3. A member of the Council commits a serious disciplinary violation if:	3. Član Saveta čini težu disciplinsku povredu ako:
3.1. nuk merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme, për dy herë me radhë, në mbledhjet e Këshillit, pa arsye të vërtetuar për raste shëndetësore apo të angazhimit profesional, i cili është planifikuar më herët;	3.1.he/she fails to participate continuously, for two consecutive times, in Council meetings without a justified reason related to health issues or previously scheduled professional engagements;	3.1. kontinuirano ne učestvuje, dva puta uzastopno, na sednicama Saveta, bez opravdanog razloga vezanog za zdravstvene probleme ili ranije planirane profesionalne obaveze;
3.2. gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nuk e respekton parimin e pavarësisë ose paanshmërisë së Këshillit, duke vepruar me paragjykime në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal të palës në procedurë;	3.2. during the performance of official duties, he/she fails to respect the principle of independence or impartiality of the Council, acting with prejudice based on race, color, gender, language, religion, political or other opinions, national or social origin, community affiliation, property, economic or social status, sexual orientation, birth, disability, or any other personal status of the party in the proceedings;	3.2.tokom obavljanja službenih dužnosti ne poštuje načelo nezavisnosti ili nepristrasnosti Saveta, postupajući sa predrasudama na osnovu rase, boje kože, pola, jezika, vere, političkog ili drugog mišljenja, nacionalnog ili društvenog porekla, pripadnosti zajednici, imovine, ekonomskog ili socijalnog statusa, seksualne orijentacije, rođenja, invaliditeta ili drugog ličnog statusa stranke u postupku;
3.3. u komunikon personave të paautorizuar informata jopublike të marra gjatë kryerjes së detyrës zyrtare si anëtar i Këshillit;	3.3. he/she communicates non-public information obtained during the performance of official duties as a member of the Council to unauthorized persons;	3.3. neovlašćenim licima saopštava ne-javne informacije dobijene tokom obavljanja službene dužnosti kao član Saveta;

3.4. pranon çfarëdolloj dhurate ose shpërblimi që mund të çojë ose duket që çon në ndikim të paligjshëm në vendimet dhe veprimet zyrtare;	3.4. he/she accepts any type of gift or reward that may lead, or appear to lead, to unlawful influence on official decisions and actions;	3.4. prima bilo kakav poklon ili nagradu koji mogu dovesti ili izgledati da dovode do nezakonitog uticaja na službene odluke i radnje;
3.5. keqpërdor pozitën zyrtare në çfarëdo forme për përfitime të paligjshme për veten ose personat e tjerë, ose për qëllime të tjera në kundërshtim me ligjin;	3.5. he/she abuses the official position in any form for unlawful benefit for himself/herself or others, or for any other purpose contrary to the law;	3.5. zloupotrebljava službeni položaj u bilo kom obliku radi nezakonite koristi za sebe ili druga lica, ili u druge svrhe suprotne zakonu;
3.6. ndërhyn në veprimet e gjyqtarëve apo zyrtarëve të tjerë me qëllim të ndikimit në aktivitetet dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj;	3.6. he/she interferes in the actions of judges or other officials with the intention of influencing their activities or decisions in any manner prohibited by law;	3.6. utiče na rad sudija ili drugih službenika sa ciljem uticanja na njihove aktivnosti ili odluke na način zabranjen zakonom;
3.7. bën deklarata publike gjatë procedurave që janë duke u zhvilluar e të cilat mund ose duket se ndikojnë negativisht në gjykim të drejtë dhe trajtim të barabartë të palëve në procedurë, ose të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë dhe reputacionin e gjykatës ose Këshillit, apo i komunikon informata publikut rreth dëshmive dhe vendimeve që kanë të bëjnë me ndonjë rast, përveç nëse zbulimi i një informacioni të tillë kërkohet me ligj;	3.7. he/she makes public statements during ongoing proceedings that may, or appear to, negatively affect fair adjudication and equal treatment of the parties, or that may harm the credibility and reputation of the court or the Council, or communicates information to the public regarding evidence or decisions related to a case, unless such disclosure is required by law;	3.7. daje javne izjave tokom postupaka koji su u toku, a koje mogu ili izgledaju da mogu negativno uticati na pravično suđenje i jednako postupanje prema strankama, ili koje mogu narušiti kredibilitet i ugled suda ili Saveta, ili javnosti saopštava informacije o dokazima ili odlukama u vezi sa nekim predmetom, osim ako je takvo otkrivanje propisano zakonom;
3.8. kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet në ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat si	3.8. he/she performs any function, duty, or service, assumes any responsibility, or engages in any activity, or runs for or is elected to any function or duty that is incompatible with the duties of a Council	3.8. obavlja bilo koju funkciju, dužnost ili službu, preuzima bilo kakvu odgovornost ili se angažuje u bilo kojoj aktivnosti, kandiduje se ili biva izabran na funkciju ili dužnost koja je nespojiva

anëtar i Këshillit sipas Kushtetutës apo legjislacionit në fuqi; 3.9. ofron informata të rrejshme ose çorientuese në çështjet që ndërlidhen me procedurat administrative apo gjyqësore.; 3.10. anëtarësohet në ndonjë subjekt politik, ose ndonjë organizatë tjetër politike, kërkon ose mban ndonjë post politik, kandidon ose zgjidhet në ndonjë post politik, apo angazhohet në ndonjë aktivitet politik.	member under the Constitution or applicable legislation; 3.9. he/she provides false or misleading information in matters related to administrative or judicial proceedings; 3.10. he/she becomes a member of a political party or any other political organization, seeks or holds any political office, runs for or is elected to any political office, or engages in any political activity.	sa obavezama člana Saveta prema ustavu ili važećem zakonodavstvu; 3.9.daje lažne ili obmanjujuće informacije u pitanjima koja se odnose na administrativne ili sudske postupke; 3.10. učlani se u politički subjekt ili drugu političku organizaciju, traži ili obavlja političku funkciju, kandiduje se ili biva izabran na političku funkciju, ili se angažuje u bilo kojoj političkoj aktivnosti.
4. Për shkelje të lehta disiplinore, anëtarit të Këshillit i shqiptohet vërejtje me shkrim.	4. For minor disciplinary violations, the member of the Council shall receive a written warning.	4. Za lakše disciplinske povrede, članu Saveta izriče se pismena opomena.
5. Për shkelje të rënda disiplinore, anëtarit të Këshillit i shqiptohet masa e shkarkimit nga funksioni.	5. For serious disciplinary violations, the member of the Council shall be dismissed from office.	5. Za teže disciplinske povrede, članu Saveta izriče se mera razrešenja sa funkcije.
6. Nëse një anëtar i Këshillit, pas kryerjes së dy (2) shkeljeve të lehta disiplinore, kryen përsëri një shkelje të lehtë disiplinore, ajo shkelje konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore sipas këtij Ligji.	6. If a member of the Council, after committing two (2) minor disciplinary violations, commits another minor disciplinary violation, that violation shall be considered a serious disciplinary violation under this law.	6. Ako član Saveta, nakon što je počinio dve (2) lakše disciplinske povrede, ponovo počini lakšu disciplinsku povredu, ta povreda smatra se težom disciplinskom povredom prema ovom zakonu.
7. Procedura hetimore e zhvilluar nga panelet disiplinore për prokurorë në Ligjin në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Prokurorëve, si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjektit disiplinor nga ai ligj, zbatohen	7. The investigative procedure developed by the disciplinary panels for prosecutors in the law in force on the disciplinary liability of prosecutors, as well as the rights and obligations of the disciplinary subject under	7. Istražni postupak koji sprovode disciplinska tela za tužioce, prema važećem zakonu o disciplinskoj odgovornosti tužioca, kao i prava i obaveze disciplinskog subjekta iz tog zakona, primenjuje se odgovarajuće

përshtatshmërisht gjatë zbatimit të procedurës hetimore disiplinore për anëtarët e Këshillit. “	that law, shall be applied mutatis mutandis during the implementation of the disciplinary investigative procedure for members of the Council. “	tokom sprovođenja disciplinskog postupka za članove Saveta. “
Neni 7	**Article 7**	**Član 7**
Emërtimi i Kapitulli IV të Ligjit bazik ndryshohet si në vijim:	The title of Chapter IV of the Basic Law shall be amended as follows:	Naslov Poglavlja IV Osnovnog zakona menja se i glasi:
“KAPITULLI IV VLERËSIMI I PERFORMANCËS, KONTROLLI I INTEGRITETIT, TRANSFERIMI DHE AVANCIMI I PROKURORËVE”	**“CHAPTER IV PERFORMANCE ASSESSMENT, INTEGRITY CONTROL, TRANSFER AND ADVANCEMENT OF PROSECUTORS”**	**“POGLAVLJE IV OCENJIVANJE UČINKA, KONTROLA INTEGRITETA, PREMEŠTAJ I UNAPREĐENJE TUŽILACA”**
Neni 8	**Article 8**	**Član 8**
Neni 27 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:	Article 27 of the Basic Law shall be reformulaed as follows:	Član 27 Osnovnog zakona preformuliše se kao u nastavku:
1. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve është organ i përhershëm i Këshillit Prokurorial, me kompetenca dhe përgjegjësi për të bërë vlerësimin e performancës së prokurorëve.	1**.** The Commission for the Evaluation of the Performance of Prosecutors shall be a permanent body of the Prosecutorial Council, with the powers and responsibilities to evaluate the performance of prosecutors.	1. Komisija za ocenjivanje učinka tužilaca je stalni organ Tužilačkog saveta, sa ovlašćenjima i odgovornostima za ocenjivanje učinka tužilaca.
2. Komisioni për Vlerësimin e Performancës i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Prokurorial.	2. The Commission for the Evaluation of the Performance shall report to and be accountable to the Prosecutorial Council.	2. Komisija za ocenjivanje učinka izveštava i odgovara Tužilačkom savetu.

3.Komisioni për Vlerësim të Performancës nga paragrafi 1 përbëhet nga pesë (5) prokurorë të emëruar nga Këshilli, duke përfshirë kryetarin e Komisionit, prej të cilëve:	3. The Commission for the Evaluation of the Performance referred to in paragraph 1 shall consist of five (5) prosecutors appointed by the Council, including the Chairman of the Commission, of whom:	3. Komisija za ocenjivanje učinka iz stava 1 sastoji se od pet (5) tužilaca koje imenuje Savet, uključujući predsednika Komisije, od kojih:
3.1 Një (1) anëtar prokuror, i cili është anëtar i Këshillit - Kryetar i Komisionit;	3.1. One (1) prosecutor member who is a member of the Council - Chairperson of the Commission	3.1. Jedan (1) član tužilac koji je član Saveta - predsednik Komisije;
3.2.Dy (2) prokurorë nga radhët e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, dhe	3.2. Two (2) prosecutors from among the prosecutors of the Office of the Chief State Prosecutor, and	3.2. Dva (2) tužioca iz reda tužilaca Kancelarije glavnog državnog tužioca, i
3.3.Dy (2) prokurorë nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit.	3.3. Two (2) prosecutors from among the prosecutors of the Appellate Prosecution Office.	3.3. Dva (2) tužioca iz reda tužilaca Apelacionog tužilaštva.
4. Kryetari i Komisionit emërohet nga radhët e anëtarëve të Këshillit, ndërsa anëtarët tjerë nga radhët e të gjithë prokurorëve tjerë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorisë së Apelit.	4. The Chairperson of the Commission shall be appointed from among the members of the Council, while the other members shall be from among all other prosecutors of the Office of the Chief State Prosecutor and the Appellate Prosecution Office.	4. Predsednik Komisije se imenuje iz reda članova Saveta, dok se ostali članovi imenuju iz reda svih ostalih tužilaca Kancelarije glavnog državnog tužioca i Apelacionog tužilaštva.
5. Në procesin e emërimit të anëtarëve të Komisionit, Këshilli siguron përfaqësimin e prokurorëve nga komunitetet joshumicë dhe respektimin e parimit të barazisë gjinore.	5. In the process of appointing members of the Commission, the Council shall ensure the representation of prosecutors from non-majority communities and the respect for principle of gender equality.	5. U procesu imenovanja članova Komisije, Savet obezbeđuje zastupljenost tužilaca iz nevećinskih zajednica i poštovanje principa rodne ravnopravnosti.

6.Mandati i anëtarit të Komisionit për Vlerësim të Performancës është pesë (5) vjet pa mundësi rizgjedhjeje në pesë (5) vitet pasuese .	6.The mandate of a member of the Performance Evaluation Commission shall be five (5) years without the possibility of re-election in the following five (5) years.	6. Mandat člana Komisije za ocenjivanje učinka je pet (5) godina bez mogućnosti ponovnog izbora u narednih pet (5) godina.
7.Komisioni përcjell zbatimin e gjetjeve nga vlerësimi individual i performancës dhe për këtë çështje raporton te Këshilli.	7.The Commission shall monitor the implementation of the findings from the individual performance evaluation and shall report on this matter to the Council.	7. Komisija prati sprovođenje nalaza iz individualnog ocenjivanja učinka i izveštava o ovom pitanju Savet.
8. Kriteret cilësore dhe sasiore, procedura dhe katër shkallët e vlerësimit të performancës së prokurorëve zbatohen sipas ligjit përkatës në fuqi për vlerësimin e performancës së prokurorëve.	8. The qualitative and quantitative criteria, procedure and four scales of performance evaluation of prosecutors shall be implemented in accordance with the relevant applicable law on the evaluation of the performance of prosecutors.	8. Kvalitativni i kvantitativni kriterijumi, postupak i četiri stepena za ocenjivanje učinka tužilaca primenjuju se u skladu sa važećim relevantnim zakonom za ocenjivanje učinka tužilaca.
9. Këshilli ushtron funksionin e mekanizmit të ankesave ndaj vlerësimeve të kryera nga Komisioni për prokurorët.	9. The Council shall exercise the function of the complaints mechanism against the evaluations conducted by the Commission for prosecutors.	9. Savet vrši funkciju mehanizma za žalbe na procene koje sprovodi Komisija za tužioce.
Neni 9	**Article 9**	**Član 9**
Pas nenit 27 të Ligjit bazik, shtohen nenet 27/A, 27 /B, dhe 27/C si në vijim:	After Article 27 of the Basic Law, the following Articles 27/A, 27/B and 27/C shall be added:	Posle člana 27 Osnovnog zakona, dodaju se članovi 27/A, 27/B i 27/C koji glase:
“	“	“
Neni 27/A **Kriteret për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve**	**Article 27/A** **Criteria for the Appointment of Members of the Commission for the Evaluation of the Performance of Prosecutors**	**Član 27/A** **Kriterijumi za imenovanje članova Komisije za ocenjivanja učinka tužilaca**

1. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve bëhet nëpërmjet një thirrjeje për nominime nga Këshilli. Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurori i Apelit nominojnë kandidatët nga prokuroritë përkatëse për emërim në Komision.	1.The appointment of members of the Commission for the Evaluation of the Performance of Prosecutors shall be made through a call for nominations by the Council. The Chief State Prosecutor and the Chief Appeal Prosecutor shall nominate candidates from the respective prosecution offices for appointment to the Commission.	1.Imenovanje članova Komisije za ocenjivanje ucinka tužilaca vrši se putem poziva za nominacije od strane Saveta. Glavni državni tužilac i glavni apelacioni tužilac nominuju kandidate iz odgovarajućih tužilaštava za imenovanje u Komisiju.
2. Anëtar i Komisionit, përveç anëtarit të Këshillit, emërohet kandidati i cili i plotëson kushtet si në vijim:	2.A candidate who meets the following conditions, except the member of the Council, shall be appointed as a member of the Commission:	2. Za člana Komisije, osim člana Saveta, biće imenovan kandidat koji ispunjava sledeće uslove:
2.1. të ketë së paku pesë (5) vjetpërvojë pune si Prokuror i Shtetit;	2.1. to have at least five (5) years of work experience as a state prosecutor;	2.1. imati najmanje pet (5) godina radnog iskustva kao državni tužilac;
2.2. të ketë së paku vlerësim në nivelin “mirë” të performancës, në vlerësimin e fundit;	2.2.to have at least an assessment at the level “good” performance, in the last assessment;	2.2. da ima najmanje ocenu “dobar“ u poslednjom ocenjivanju;
2.3.të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore gjatë pesë (5) viteve të fundit;	2.3. to have no disciplinary measure imposed during the last five (5) years;	2.3. da nema izrećenu disciplinsku meru u poslednjih pet (5) godina;
2.4. të mos ketë procedurë disiplinore në zhvillim për shkelje të rënda disiplinore.	2.4.to have no ongoing disciplinary proceedings for serious disciplinary violations.	2.4. da nema tekući disciplinski postupak za teške disciplinske prekršaje.
Neni 27/B **Përfundimi i mandatit të anëtarit të Komisionit**	**Article 27/B** **Termination of the mandate of a member of the Commission**	**Član 27/B** **Prestanak mandata člana komisije**
1.Mandati i anëtarit të Komisionit përfundon:	1.The mandate of a member of the Commission shall terminate:	1. Mandat člana komisije prestaje:

1.1. me skadimin e mandatit, për të cilin është emëruar;	1.1. upon the expiration of the mandate for which he/she was appointed;	1.1.po isteku mandata na koji je imenovan
1.2. me dorëheqje;	1.2. upon resignation;	1.2. ostavkom;
1.3.me përfundimin e mandatit si prokuror, dhe	1.3. upon the termination of the mandate as a prosecutor, and	1.3. po završetku mandata kao tužilac, i
1.4.nëse i është shqiptuar masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore.	1.4. if a disciplinary measure has been imposed on him/her for a serious disciplinary violation.	1.4. ukoliko mu je izrečena disciplinska mera za težak disciplinski prekršaj.
2.Shkarkimi i anëtarit të Komisionit bëhet nga Këshilli në rastet e shqiptimit të masës disiplinore sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.4 të këtij neni.	2.The dismissal of a member of the Commission shall be carried out by the Council in cases of imposition of a disciplinary measure pursuant to paragraph 1, subparagraph 1.4 of this Article.	2. Razrešenje člana Komisije vrši Savet u slučajevima izricanja disciplinske mere prema stavu 1, podstav 1.4 ovog člana.
Neni 27/C **Vlerësimi i performancës së kryeprokurorëve**	**Article 27/C** **Performance Evaluation of Chief Prosecutors**	**Član 27/C** **Ocenjivanje učinka glavnih tužilaca"**
1.Vlerësimi i performancës së kryeprokurorëve bëhet nga Kryeprokurori i Shtetit.	1.The performance evaluation of Chief Prosecutors shall be carried out by the Chief State Prosecutor.	1. Ocenjivanje Učinka Glavnih Tužilaca vrši Glavni Državni Tužilac.
2. Kriteret për vlerësim të performancës së kryeprokurorit përfshijnë organizimin dhe udhëheqjen e punës së Prokurorisë, efikasitetin e funksionimit të saj, nivelin e transparencës institucionale dhe kompetencat personale të kryeprokurorit, siç	2. The criteria for the performance evaluation of the Chief Prosecutor shall include the organization and management of the work of the Prosecution Office, the efficiency of its functioning, the level of institutional transparency, and the personal competencies	2. Kriterijumi za ocenjivanje učinka glavnog tužioca obuhvataju organizaciju i rukovođenje radom Tužilaštva, efikasnost njegovog funkcionisanja, nivo institucionalne transparentnosti, kao i lične kompetencije glavnog tužioca, kako su dalje

definohen tutje bashkë me procedurën dhe shkallët e vlerësimit në ligjin përkatës për vlerësimin e performancës së prokurorëve.	of the Chief Prosecutor, as further defined together with the procedure and levels of evaluation in the relevant law on the performance evaluation of prosecutors.	definisani zajedno sa procedurom i stepenima ocenjivanja u odgovarajućem zakonu o ocenjivanju učinka tužilaca.
Neni 10	**Article 10**	**Član 10**
Neni 28 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:	Article 28 of the Basic Law shall be reformulated as follows:	Član 28 osnovnog Zakona se preformuliše na sledeći način:
Neni 28 **Transferimi dhe avancimi i prokurorëve**	**Article 28** **Transfer and Promotion of Prosecutors**	**Član 28** **Premeštaj i unapređenje tužilaca**
Transferimi dhe avancimi i prokurorëve bëhet në përputhje me kushtet dhe procedurën përkatëse të përcaktuar në ligjin përkatës për statusin e prokurorëve.	Transfer and promotion of prosecutors shall be carried out in accordance with the relevant conditions and procedure set out in the relevant Law on the Status of Prosecutors.	Premeštaj i unapređenje tužilaca vrši se u skladu sa uslovima i odgovarajućom procedurom utvrđenom u relevantnom Zakonu o statusu tužilaca.
Neni 11	**Article 11**	**Član 11**
1. Neni 29 i Ligjit bazik fshihet.	1. Article 29 of the Basic Law shall be deleted.	1. Član 29 osnovnog zakona se briše.
2. Para emërtimit të nenit 31 të Ligjit bazik shtohet emërtimi “Kapitulli IV/A Administrata e Sistemit Prokurorial”.	2. Before the title of Article 31 of the Basic Law, the title ‘Chapter IV/A – Administration of the Prosecutorial System’ shall be added.	2. Pre naziva člana 31 osnovnog zakona dodaje se naziv ‘Poglavlje IV/A – Administracija tužilačkog sistema’.
Neni 12	**Article 12**	**Član 12**
Pas nenit 31 të Ligjit bazik shtohet neni i ri 31/A si në vijim:	After Article 31 of the Basic Law, new Articles 31/A shall be added as follows:	Posle člana 31 Osnovnog zakona dodaje se novi Član 31/A kako sledi:

Neni 31/A Njësia për Inspektim dhe Verifikim	Article 31/A Inspection and Verification Unit	Član 31/A Jedinica za Inspekciju i Verifikaciju
1.Njësia për Inspektim dhe Verifikim (në tekstin e mëtejmë: NJIV) është njësi e veçantë mbështetëse profesionale në kuadër të strukturës organizative të Këshillit Prokurorial.	1. The Inspection and Verification Unit (hereinafter: IVU) is a special professional support unit within the organizational structure of the Prosecutorial Council.	1.Jedinica za Inspekciju i Verifikaciju (u daljem tekstu: JIV) je posebna stručna podrška u okviru organizacione strukture Tužilačkog Saveta.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e NJIV-së janë si në vijim:	2. The duties and responsibilities of the IVU shall be as follows:	2. Zadaci i odgovornosti JIV su kako sledi:
2.1. mbështet Këshillin dhe Komisionet përkatëse për administrimin e prokurorive, rekrutimin, performancën dhe disiplinën e prokurorëve;	2.1. supports the Council and the relevant Commissions for the administration of prosecutions, recruitment, performance and discipline of prosecutors;	2.1. pruža podršku Savetu i nadležnim Komisijama u upravljanju tužilaštvima, regrutaciju, ocenjivanju učinka i disciplini tužilaca;
2.2. zhvillon inspektime në prokuroritë e Republikës së Kosovës;	2.2. conducts inspections in the prosecution offices of the Republic of Kosovo;	2.2. sprovodi inspekcijske nadzore u tužilaštvima Republike Kosovo
2.3. i propozon Këshillit politika dhe udhëzime për reformimin apo përmirësimin e punës së prokurorive;	2.3. proposes policies and guidelines to the Council for reforming or improving the work of prosecution offices;	2.3. predlaže Savetu politike i smernice za reformu ili unapređenje rada tužilaštava;
2.4. mbështet zhvillimin e procedurës së hetimit administrativ të kontrollit të integritetit, duke mbledhur, përpunuar të dhënat dhe përgatitur raportet përkatëse për kandidatët për prokurorë;	2.4.supports the development of the administrative investigation procedure for integrity control, by collecting, processing data and preparing relevant reports for candidates for prosecutors;	2.4.pruža podršku sprovođenju postupka administrativne istrage kontrole integriteta, prikupljajući i obrađujući podatke i pripremajući odgovarajuće izveštaje za kandidate za tužioce;

2.5.ofron mbështetje në përgatitjen e metodologjive të kontrollit të integritetit;	2.5. provides support in the preparation of integrity control methodologies;	2.5.pruža podršku u pripremi metodologija kontrole integriteta;
2.6.mbledh burimet përkatëse të vlerësimit të performancës, të nevojshme për vlerësimin e performancës së prokurorëve, dhe	2.6. collects relevant performance evaluation resources necessary for the evaluation of the performance of prosecutors, and	2.6.prikuplja odgovarajuće izvore za ocenjivanje učinka, neophodne za ocenjivanje učinka tužilaca, i
2.7. paraqet ankesa disiplinore, bazuar në gjetjen e raportit të inspektimit , tek autoriteti kompetent për shkeljet disiplinore të identifikuara të prokurorëve, në përputhje me Ligjin përkatës për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve.	2.7. submits disciplinary complaints, based on the inspection findings report, to the competent authority for identified disciplinary violations of prosecutors, in accordance with the relevant Law on the disciplinary responsibility of prosecutors.	2.7.podnosi disciplinske žalbe na osnovu izveštaja o nalazima inspekcije nadležnom organu za utvrđene disciplinske prekršaje tužilaca, u skladu sa relevantnim Zakonom o disciplinskoj odgovornosti tužilaca.
3. NJIV-ja ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur, mbi bazën e kërkesave të komisioneve apo Kryesuesit të Këshillit sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, dhe raporton para komisioneve për zbatimin e tyre.	3.The IVU exercises its duties and responsibilities independently, based on the requests of the Council committees or the Chair of the Council according to the procedures set out in the legislation in force, and reports to the committees on their implementation.	3.JIV obavlja zadatke i odgovornosti nezavisno, na osnovu zahteva komisija Saveta ili predsednika Saveta u skladu sa procedurama utvrđenim važećim zakonodavstvom, i izveštava komisije o njihovom sprovođenju.
4.NJIV-ja mban përgjegjësi të plotë të llogaridhënies para Këshillit Prokurorial të Kosovës.	4. The IVU shall be fully accountable to the Kosovo Prosecutorial Council.	4.JIV snosi punu odgovornost za izveštavanje pred Tužilačkim Savetom Kosova.
5. NJIV-ja përbëhet nga udhëheqësi dhe të paktën shtatë (7) nëpunës të tjerë civilë, me status të veçantë sipas Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë. Rekrutimi i tyre bëhet nga Komisioni i emëruar nga Këshilli	5. The IVU shall consist of the head and at least seven (7) other civil servants, with a special status according to applicable Llaw on Public Officials. Their recruitment shall be carried out by the Commission appointed by	5. JIV se sastoji od rukovodioca i najmanje sedam (7) drugih civilnih službenika, sa posebnim statusom u skladu sa važećim Zakonom o Javnim Službenicima. Njihovo regrutaciju vrši komisija imenovana od

Prokurorial përmes një procedure të hapur dhe publike.	the Prosecutorial Council through an open and public procedure.	strane Tužilačkog Saveta putem otvorene i javne procedure.
6.Përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të përcaktuara me li gjin përkatës për zyrtarët publikë, zyrtari i NJIV-së duhet t'i plotësojë kushtet e veçanta si në vijim:	6. In addition to the general employment conditions determined by the relevant law for public officials, the IVU officer shall meet the following specific conditions:	6.Pored opštih uslova za zapošljavanje utvrđenih posebnim zakonom o javnim službenicima, službenik JIV mora ispunjavati sledeće posebne uslove:
6.1.të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë, ose të kriminologjisë, kriminalistikës, ekonomisë, administratës publike apo fusha të ngjashme;	6.1. to have a university degree in the field of justice, criminology, criminalistics, economy, public administration or similar fields;	6.1. posedovati univerzitetsku diplomu iz oblasti prava, kriminologije, kriministike, ekonomije, javne uprave ili srodnih oblasti;
6.2.të ketë së paku pesë (5) vjet të përvojës së punës në inspektim, verifikim, hetuesi apo detyra të ngjashme;	6.2. to have at least five (5) years of work experience in inspection, verification, investigator or similar duties;	6.2.imati najmanje pet (5) godina radnog iskustva u inspekciji, verifikaciji, istražiteljskim ili srodnim poslovima;
6.3. të ketë integritet;	6.3. to have integrity;	6.3. imati integritet;
6.4. të mos ketë aktakuzë të ngritur;	6.4. to have no indictment filed;	6.4. ne biti podignuta optužnica;
6.5. të mos jetë i dënuar për vepër penale, me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia.	6.5.not to have been convicted of a criminal offense, excluding criminal offences committed by negligence.	6.5. ne biti osuđen za krivično delo, osim krivičnih dela učinjenih iz nehata.
7. Procedura e kontrollit të integritetit të zyrtarëve të NJIV-së zbatohet përshtatshmërisht sipas procedurës së kontrollit të integritetit për kandidatët për prokurorë, nga neni 29 i ligjit në fuqi për rekrutimin e prokurorëve.	7.The integrity control procedure for IJU officials is implemented accordingly according to the integrity control procedure for candidates for prosecutors, from Article 29 of the law in force on the recruitment of prosecutors..	7.Postupak kontrole integriteta za službenike IJU sprovodi se shodno postupku kontrole integriteta za kandidate za tužioce, iz člana 29. važećeg zakona o zapošljavanju tužilac.

8. Zyrtarët e NJIV-së e deklarojnë pasurinë në përputhje me ligjin përkatës në fuqi për deklarimin e pasurisë.	8. Officers of the IVU shall declare their assets in accordance with the relevant applicable Law on the Declaration of Assets.	8. Službenici JIV prijavljuju imovinu u skladu sa važećim zakonom o prijavi imovine.
9. Udhëheqësi dhe zyrtarët e NJIV-së emërohen sipas mandateve përkatëse të përcaktuara në Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë.	9. The Head and officers of the IVU shall be appointed according to the respective mandates set forth in the applicable law for public officials.	9. Rukovodilac i službenici JIV se imenuju u skladu sa mandatima utvrđenim važećim zakonom o javnim službenicima.
10. Pagat dhe shtesat tjera të zyrtarëve dhe të Udhëheqësit të Njësisë rregullohen me ligjin përkatës për pagat.	10. Salaries and other allowances of officers and heads of the Unit shall be regulated by the relevant Law on Salaries.	10. Plate i druge dodatke službenika i rukovodioca jedinice regulišu posebni zakoni o platama.
11.Mandati i Udhëheqësit të NJIV-së dhe marrëdhënia e punës së zyrtarëve të NJIV-së mund të përfundojnë para kohës në bazë të përcaktimeve të Ligjit për Zyrtarë Publikë, për të cilat vendos Këshilli Prokurorial i Kosovës pas zhvillimit të procedurës disiplinore.	11. The mandate of the Head of the IVU and the employment relationship of officers of the IVU may be terminated prematurely based on the provisions of the Law on Public Officials, which shall be decided by the Kosovo Prosecutorial Council after the conduct of the disciplinary procedure.	11. Mandat Rukovodioca JIV i radni odnos službenika JIV može biti okončan pre vremena u skladu sa odredbama zakona o javnim službenicima, o čemu odlučuje Tužilački savet Kosova nakon sprovedene disciplinske procedure.
Neni 13	**Article 13**	**Član 13**
1.Neni 32, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit bazik riformulohet si në vijim:	1. Article 32, paragraph 1, subparagraph 1.1 of the basic Law shall be reformulated as follows:	1.Član 32, stav 1. podstav 1.1. Osnovnog Zakona preformuliše se kao u nastavku:
"1.1.përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli, në përputhje me rregullat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe kushtet e veçanta apo shtesë të përcaktuara me akt nënligjor nga Këshilli".	"1.1.selected, appointed and dismissed by the Council, in accordance with the rules of the Law on Public Officials, and the special or additional conditions determined by a sub-legal act of the Council."	"1.1.bira se, imenuje i razrešava od Saveta, u skladu sa pravilima Zakona o javnim službanicima, i posebnim ili dodatnim uslovima utvrđenim podzakonskim aktom od Savetautvrđuje."

Neni 14	Article 14	Član 14
Pas nenit 32 të Ligjit bazik, shtohen nenet 32/A, 32/B, 32/C, 32/D, 32/E dhe 32/F si në vijim:	After Article 32 of the Basic Law, articles 32/A, 32/B, 32/C, 32/D, 32/E and 32/F shall be added as follows :	Posle člana 32 Osnovnog zakona, Članovi 32/A, 32/B, 32/C, 32/D, 32/E i 32/F, kako sledi:
Neni 32/A **Administrata e Sistemit Prokurorial**	**Article 32/A** **Administration of the Prosecutorioal System**	**Član 32/A** **Administracija tužilačkog sistema**
1.Administrata e Sistemit Prokurorial ofron shërbime profesionale dhe administrative për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Këshilli.	1. Administration of the Prosecutorial System shall provide professional and administrative services to the Kosovo Prosecutorial Council and the prosecution offices of the Republic of Kosovo in accordance with the legislation in force and the acts adopted by the Council.	1. Administracija tužilačkog sistema pruža stručne i administrativne usluge Tužilačkom Savetu Kosova i tužilaštvima Republike Kosovo u skladu sa važećim zakonodavstvom i aktima ko usvojene od Saveta.
2.Shërbimet nga paragrafi 1 përfshijnë:	2. The services referred to in paragraph 1 shall include:	2.Usluge iz stava 1 obuhvataju:
2.1.Sigurimin e kushteve për punë të rregullt të prokurorive dhe Këshillit;	2.1.Ensuring the conditions for the regular functioning of the prosecution offices and the Council;	2.1.Obezbeđivanje uslova za redovan rad tužilaštava i Saveta;
2.2.Mbështetjen e prokurorëve në mbajtjen e procesverbaleve, hartimin e dokumenteve, mbarëvajtjen e procedurave dhe çështjeve tjera të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre, përfshirë ato të Këshillit;	2.2.Supporting prosecutors in record-keeping, drafting documents, smooth conducting proceedings, and other matters related to the exercise of their duties and responsibilities, including those of the Council;	2.2.Pružanje podrške tužiocima u vođenju zapisnika, izradi dokumenata, nesmetanom odvijanju postupaka i drugim pitanjima u vezi sa izvršavanjem njihovih dužnosti i odgovornosti, uključujući i one Saveta;

2.3.Ofrimin e mbështetjes për dëshmitarët dhe viktimat në procedura të ndryshme, në përputhje me kompetencat ligjore;	2.3.Providing support to witnesses and victims in various proceedings, in accordance with legal competencies;	2.3.Pružanje podrške svedocima i žrtvama u različitim postupcima, u skladu sa zakonskim nadležnostima;
2.4.Sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale në procedurat e ndryshme sipas legjislacionit në fuqi;	2.4. Ensuring the protection of personal data in various proceedings in accordance with the legislation in force;	2.4. Obezbeđivanje zaštite ličnih podataka u različitim postupcima u skladu sa važećim zakonodavstvom;
2.5. Shërbimet e teknologjisë së informacionit, përfshirë sistemin për menaxhimin e lëndëve;	2.5. Providing information technology services, including the case management system;	2.5. Usluge informacionih tehnologija, uključujući sistem za upravljanje predmetima;
2.6. Mbledhjen e të dhënave statistikore, analizimin e tyre dhe përgatitjen e raporteve përkatëse;	2.6. Collecting and analyzing statistical data and preparing relevant reports;	2.6. Prikupljanje statističkih podataka, njihova analiza i izrada odgovarajućih izveštaja;
2.7.Shërbimet e menaxhimit financiar, ekzekutimit të buxhetit dhe raportimit financiar;	2.7. Providing financial management, budget execution, and financial reporting services;	2.7. Usluge finansijskog upravljanja, izvršenja budžeta i finansijskog izveštavanja;
2.8.Pranimin, arkivimin, daljen dhe dërgimin e shkresave lidhur me punën dhe procedurat e ndryshme në Sistemin Prokurorial;	2.8. Receiving, archiving, issuing, and sending documents related to the work and various proceedings within the Prosecutorial system;	2.8. Prijem, arhiviranje, otpremu i slanje podnesaka u vezi sa radom i različitim postupcima u tužilačkom sistemu;
2.9. Menaxhimin dhe mbarëvajtjen e ndërtesave dhe hapësirave të punës së sistemit prokurorial në përputhje me kompetencat ligjore;	2.9. Managing and maintaining the buildings and workspaces of the prosecutorial system in accordance with legal competencies;	2.9. Upravljanje i održavanje zgrada i radnih prostora tužilačkog sistema u skladu sa zakonskim nadležnostima;

2.10. Komunikimin me publikun për punën e Sistemit Prokurorial, dhe	2.10. Communicating with the public regarding the work of the Prosecutorial system; and	2.10. Komunikaciju sa javnošću o radu tužilačkog sistema, i
2.11. Detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me akte nënligjore apo vendime të Këshillit.	2.11. Other duties and responsibilities as determined by sub-legal acts or decisions of the Council.	2.11. Druge dužnosti i odgovornosti utvrđene podzakonskim aktima ili odlukama Saveta.
3.Organizimi i brendshëm i administratës së Sistemit Prokurorial përcaktohet me ligjin përkatës të Këshillit dhe aktet e brendshme të tij.	3.The internal organization of the administration of the prosecutorial system shall be determined by the Law on the Prosecutorial Council and its internal acts.	3.Unutrašnja organizacija administracije tužilačkog sistema utvrđuje se odgovarajućim Zakonom Saveta i njegovim internim aktima.
Neni 32/B **Nëpunësit civilë të administratës së Sistemit Prokurorial**	**Article 32/B** **Civil Servants of the Administration of the Prosecutorial System**	**Član 32/B** **Državni službenici administracije tužilačkog sistema**
1.Administrata e Sistemit Prokurorial përbëhet nga nëpunës civilë me status të veçantë dhe nëpunës teknikë dhe mbështetës sipas Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë.	1. The Administration of the Prosecutorial System shall consist of civil servants with special status, as well as technical and support staff, in accordance with the Law in force on Public Officials.	1.Administracija tužilačkog sistema sastoji se od državnih službenika sa posebnim statusom, kao i tehničkog i pomoćnog osoblja u skladu sa važećim Zakonom o Javnim Službenicima.
2. Dispozitat e Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë zbatohen për rregullimin e marrëdhënies së punës së këtyre nëpunësve.	2.The provisions of the Law in force on Public Officials shall apply to the regulation of the employment relationship of these civil servants.	2.Odredbe važećeg Zakona o Javnim Službenicima primenjuju se za uređivanje radnog odnosa ovih službenika.
3.Këshilli nxjerr akte nënligjore për zbatimin e dispozitave të Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë. Përjashtimisht, aktet nënligjore të Këshillit mund të rregullojnë ndryshe, në pajtim me parimet e përcaktuara me Ligjin	3. The Council shall issue sub-legal acts for the implementation of the provisions of the Law in force on Public Officials. Exceptionally, the Council's sub-legal acts may regulate differently, in accordance with	3.Savet donosi podzakonske akte za sprovođenje odredbi važećeg Zakona o Javnim Službenicima. Izuzetno, podzakonski akti Saveta mogu drugačije uređivati, u skladu sa principima utvrđenim

në fuqi për Zyrtarët Publikë, elementet e marrëdhënies së punës si në vijim:	the principles set out in the Law in force on Public Officials, the following elements of the employment relationship:	važećim Zakonom o Javnim Službenicima, sledeće elemente radnog odnosa:
3.1.kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim;	3.1.special or additional conditions for recruitment;	3.1. posebni ili dodatni uslovi za regrutovanje;
3.2.të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë;	3.2.specific rights or obligations other than those provided for in the Law in force on Public Officials;	3.2. druga specifična prava ili obaveze koja se razlikuju od onih predviđenih važećim Zakonom o Javnim Službenicima;
3.3.trajnimet dhe zhvillimin profesional;	3.3.training and professional development;	3.3. obuke i stručni razvoj;
3.4.transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve;	3.4. transfer and sistematization of civil servants;	3.4.transfer i sistematizaciju službenika;
3.5.përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë;	3.5.determination of violations and additional disciplinary measures;	3.5.utvrđivanje prekršaja i dodatnih disciplinskih mera;
3.6. disiplinën dhe vlerësimin.	3.6. discipline and evaluation.	3.6. disciplinu i ocenjivanje.
4. Marrëdhënia e punës së nëpunësve teknikë dhe mbështetës rregullohet me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe legjislacionin e punës. Procedura e rekrutimit të stafit teknik dhe mbështetës përcaktohet me akte nënligjore të miratuara nga Këshilli.	4. The employment relationship of technical and support staff shall be governed by the Law on Public Officials and labour legislation. The procedure for recruiting technical and support staff shall be determined by sub-legal acts approved by the Council.	4.Radni odnos tehničkog i pomoćnog osoblja uređuje se Zakonom o Javnim Službenicima i radnim zakonodavstvom. Procedura regrutovanja tehničkog i pomoćnog osoblja utvrđuje se podzakonskim aktima koje donosi Savet.

Neni 32/C Administratorët e prokurorive	Article 32/C Administrators of the Prosecution Offices	Član 32/C Administratori tužilaštava
1. Administratori i Prokurorisë zgjidhet dhe shkarkohet nga Këshilli përmes Sekretariatit në pajtim me rregullat e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe kushtet e veçanta apo shtesë të përcaktuara nga Këshilli me akt nënligjor.	1. A prosecution office administrator shall be elected and dismissed by the Council through the Secretariat in accordance with the rules of the Law on Public Officials and the special or additional conditions determined by the Council through a sub-legal act.	1.Administrator Tužilaštva se imenuje i razrešava od strane Saveta preko Sekretarijata u skladu sa pravilima Zakona o Javnim Službenicima i posebnim ili dodatnim uslovima koje Savet utvrđuje podzakonskim aktom.
2.Administratori për punën e tij është përgjegjës para Kryeprokurorit, Këshillit dhe Drejtorit të Sekretariatit sipas përcaktimeve të aktit nënligjor të Këshillit.	2. An administrator shall be accountable for his or her work to the Chief Prosecutor of the Prosecution office, the Council, and the Director of the Secretariat, as determined by a sub-legal act of the Council.	2.Administrator za svoj rad je odgovoran pred Glavnog tužioca, Saveta i Direktoru Sekretarijata u skladu sa odredbama podzakonskog akta Saveta.
3.Administratorët e prokurorive kanë për detyrë të mbikëqyrin:	3.The prosecution offices administrators shall have the duty to supervise:	3.Administratori tužilaštava imaju dužnost da nadgledaju:
3.1.hartimin e raporteve të prokurorisë, duke përfshirë raportet statistikore, dhe të sigurojnë që ato të jenë të sakta dhe të përgatiten me kohë;	3.1.the compilation of prosecution offices' reports, including statistical reports, and ensuring their accuracy and timeliness;	3.1.izradu izveštaja tužilaštva, uključujući statističke izveštaje, i obezbeđivanje da iste budu tačne i pravovremeno pripremljene;
3.2.regjistrimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurorisë dhe lëndëve të mbyllura;	3.2.the recording and archiving of a prosecution office files and closed cases;	3.2.registraciju i arhiviranje predmeta tužilaštva i zatvorenih slučajeva;
3.3.mirëmbajtjen e dosjeve të prokurorisë në formë të plotë dhe të saktë;	3.3.the maintenance of a prosecution office files in a complete and accurate form;	3.3.održavanje predmeta tužilaštva u potpunom i tačnom obliku;
3.4. sigurinë e prokurorisë;	3.4. a prosecution office security;	3.4. bezbednost tužilaštva;

3.5. stafin administrativ të prokurorisë;	3.5. a prosecution office administrative staff;	3.5. administrativno osoblje tužilaštva;
3.6.zbatimin e rregulloreve për personelin prokurorial;	3.6. the implementation of regulations applicable to prosecutorial personnel;	3.6. sprovođenje pravilnika za tužilačko osoblje;
3.7.mirëmbajtjen e saktë të financave;	3.7. the proper maintence of finances;	3.7. precizno vođenje finansija;
3.8. zbatimin e rregulloreve të Këshillit dhe procedurave të themeluara nga Këshilli;	3.8.the implementation of Council regulations and procedures established by the Council,	3.8.sprovođenje pravilnika Saveta i procedura osnovane od Saveta;
3.9. sigurimin e qasjes së publikut në regjistrat e prokurorisë dhe informacionin që mund të zbulohet për publikun, në pajtim me ligjet në fuqi.	3.9. the provision of public access to a prosecution office records and information that may be disclosed to public in accordance with applicable laws.	3.9. obezbeđivanje pristupa javnosti u evidencijama tužilaštva i informacijama koje mogu biti dostupne javnosti, u skladu sa važećim zakonima.
4.Administratori kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera, siç mund të caktohen nga Kryeprokurori.	4.An Administrator shall undertake also other duties and responsibilities as may be assigned by the Chief Prosecutor.	4.Administrator obavlja druge dužnosti i odgovornosti kako mogu odrediti od glavnog tužioca.
5. Administratori cakton, sipas nevojës, stafin administrativ në detyra të caktuara për të siguruar veprimin efektiv dhe efikas të prokurorisë.	5.An Administrator shall assign, as necessary, administrative staff to specific duties to ensure the effective and efficient operation of the Prosecution Office.	5.Administrator određuje, prema potrebi, administrativno osoblje za obavljanje određenih zadataka obezbeđivanje efikasnog i efektivnog funkcionisanja tužilaštva.
Neni 32/D **Bashkëpunëtorët profesionalë**	**Article 32/D** **Professional Assocites**	**Član 32/D** **Stručni saradnici**
1. Bashkëpunëtorët profesionalë rekrutohen nga Këshilli, përmes Sekretariatit, në pajtim me rregullat e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe	1.Professional associates shall be recruited by the Council through the Secretariat in accordance with the rules of the Law on	1.Stručni saradnici se regrutuju od Saveta preko Sekretarijata u skladu sa pravilima Zakona o Javnim Službenicima i posebnim

kushtet e veçanta apo shtesë të përcaktuara nga Këshilli me akt nënligjor.	Public Officials and any special or additional conditions determined by the Council through a sub-legal act.	ili dodatnim uslovima koje Savet utvrđuje podzakonskim aktom.
2. Bashkëpunëtorët profesionalë mbikëqyren nga prokurorët për të cilët ofrojnë shërbimet e tyre profesionale, si dhe nga administratorët.	2. Professional associates shall be supervised by prosecutors for whom they provide their professional services, as well as by the administrators.	2.Stručni saradnici se nadziru od strane tužilaca za koje pružaju svoje stručne usluge, kao i od administratora.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta të bashkëpunëtorëve profesionalë caktohen me aktet nënligjore për klasifikimin e vendeve të punës të Këshillit.	3. The specific duties and responsibilities of professional associates shall be determined by the sub-legal acts on the classification of the Council's job positions.	3.Posebne dužnosti i odgovornosti stručnih saradnika određuju se podzakonskim aktima o klasifikaciji radnih mesta Saveta.
Neni 32/E **Përkthyesit dhe interpretët**	**Article 32/E** **Translators and Interpreters**	**Član 32/E** **Prevodioci i tumači**
1. Përkthyesit dhe interpretët e brendshëm rekrutohen nga Këshilli përmes Sekretariatit në pajtim me rregullat e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe kushtet e veçanta apo shtesë të përcaktuara nga Këshilli me akt nënligjor.	1. Internal translators and interpreters shall be recruited by the Council through the Secretariat in accordance with the rules of the Law on Public Officials and the special or additional conditions established by the Council by sub-legal act.	1.Unutrašnji prevodioci i tumači se regrutuju od strane Saveta preko Sekretarijata u skladu sa pravilima Zakona o Javnim Službenicima i posebnim ili dodatnim uslovima utvrđenim od Saveta sa podzakonskim aktom.
2. Përkthyesit dhe interpretët ofrojnë shërbime të përkthimit dhe interpretimit sipas organizimit të punës së Këshillit dhe prokurorive.	2. Translators and interpreters shall provide translation and interpretation services according to the organization of the work of the Council and prosecution offices.	2.Prevoditelji i tumači pružaju usluge prevođenja i tumačenja u skladu sa organizacijom rada Saveta i tužilaštava.

Neni 32/F Pozitat e tjera në administratën e Sistemit Prokurorial	Article 32/F Other Positions in the Administration of the Prosecutorial System	Član 32/F Ostale pozicije u administraciji tužilačkog sistema
Në administratën e Sistemit Prokurorial janë të punësuar nëpunësit dhe zyrtarët tjerë sipas përcaktimeve të nenit 32/B, në përputhje me organizimin e brendshëm të përcaktuar nga Këshilli dhe aktet përkatëse për klasifikimin e vendeve të punës.	In the Administration of the Prosecutorial System, there are employed civil servants and other officials according to the provisions of Article 32/B, in accordance with the internal organization established by the Council and the relevant acts on the classification of jobs.	U administraciji tužilačkog sistema zaposleni su službenici i drugi zvaničnici u skladu sa odredbama člana 32/B, u skladu sa unutrašnjom organizacijom koju utvrđuje Savet i odgovarajućim aktima o klasifikaciji radnih mesta**.**
Neni 15 **Dispozitat kalimtare**	**Article 15** **Transitional provisions**	**Član 15** **Prelazne odredbe**
1.Përjashtimisht dispozitave të këtij Ligji, anëtarët e Komisionit të parë për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve, përveç anëtarit të Këshillit, nga neni 27 i ligjit pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të zgjidhen sipas shortit me mandate të përshkallëzuara, prej të cilëve:	1.Notwithstanding the provisions of this Law, the members of the first Commission for the Evaluation of the Performance of Prosecutors, except of the Council member, referred to Article 27 of the law after the entry into force of this Law, shall be selected by lot with staggered mandates, as follows:	1.Izuzev odredaba ovog Zakona, članovi prve Komisije za Ocenjivanje Učinka tužilaca, osim člana Saveta, iz člana 27 zakona nakon stupanja na snagu ovog Zakona, biraće se prema žrebu sa stepenastim mandatima, i to:
1.1. Nga dy (2) prokurorët nga radhët e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) me mandat për pesë (5) vjet dhe tjetri me mandat për katër (4) vjet;	1.1. Of the two (2) prosecutors from the Office of the State Prosecutor, one (1) shall have a five (5)-year mandate and the other shall have a four (4)-year mandate;	1.1. Od dva (2) tužioca iz redova tužilaca Kancelarije Državnog tužioca, jedan (1) će imati mandat od pet (5) godina, a drugi mandat od četiri (4) godine;
1.2. Nga dy (2) prokurorët nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit, një (1) me mandat për pesë (5) vjet dhe një (1) tjetër me mandat për katër (4) vjet.	1.2. Of the two (2) prosecutors from the Appellate Prosecution Office, one (1) shall have a five (5)-year mandate and the other shall have a four (4)-year mandate.	1.2. Od dva (2) tužioca iz redova tužilaca Apelacionog tužilaštva, jedan (1) ima mandat od pet (5) godina, a drugi mandat od četiri (4) godine.

2.Zyrtarët aktualë për verifikim në kuadër të Njësisë për Verifikim të Këshillit i nënshtrohen procedurës së kontrollit të integritetit, brenda periudhës prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.	2. The current officials subject to verification within the Council's Verification Unit shall undergo the integrity control procedure within six (6) months from the entry into force of this Law.	2. Sadašnji službenici koji podležu verifikaciji u okviru Jedinice za verifikaciju Veća podvrgavaju se postupku provere integriteta u roku od šest (6) meseci od dana stupanja na snagu ovog zakona.
3. Kontrolli i integritetit për zyrtarët aktualë nga paragrafi 2 i këtij neni, zhvillohet nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive në kuadër të Këshillit.	3. The integrity control for the current officials referred to in paragraph 2 of this Article shall be conducted by the Commission for the Administration of Prosecutions within the Council.	3. Proveru integriteta za sadašnje službenike iz stava 2 ovog člana sprovodi Komisija za administriranje tužilaštava u okviru Veća.
4. Kjo procedurë e kontrollit të integritetit zhvillohet përshtatshmërisht me procedurën e kontrollit të integritetit për kandidatët për prokurorë, të përcaktuar në nenin 29 të ligjit në fuqi për rekrutimin e prokurorëve, duke u zbatuar të gjitha fazat, standardet dhe kriteret që janë të zbatueshme sipas atij neni.	4. This integrity control procedure shall be carried out mutatis mutandis in accordance with the integrity control procedure for candidates for prosecutors, as defined in Article 29 of the applicable law on the recruitment of prosecutors, applying all phases, standards, and criteria that are applicable under that Article.	4. Ovaj postupak provere integriteta sprovodi se shodno postupku provere integriteta za kandidate za tužioce, utvrđenom članom 29 važećeg zakona o regrutovanju tužilaca, primenom svih faza, standarda i kriterijuma koji su primenljivi prema tom članu.
5. Kundër vendimit të Komisionit për Rekrutim, të marrë gjatë kësaj procedure, lejohet ankesë në Këshill.	5. An appeal may be filed with the Council against the decision of the Recruitment Commission issued during this procedure.	5. Protiv odluke Komisije za regrutaciju, donete tokom ovog postupka, dozvoljena je žalba Veću.
6. Zyrtarët të cilët e kalojnë me sukses kontrollin e integritetit konfirmohen në detyrë dhe bëhen pjesë e NJIV-së.	6. Officials who successfully pass the integrity control shall be confirmed in their position and become part of the Verification Unit (NJIV).	6. Službenici koji uspešno prođu proveru integriteta potvrđuju se na dužnost i postaju deo Jedinice za inspekciju i verifikaciju (NJIV).
7. Në rast se zyrtari nuk e kalon kontrollin e integritetit, ai apo ajo transferohet në detyra të tjera brenda Sekretariatit të Këshillit, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi që	7. If an official does not pass the integrity control, he or she shall be transferred to other duties within the Secretariat of the Council, in accordance with the applicable legal	7. Ukoliko službenik ne prođe proveru integriteta, on ili ona se raspoređuje na druge poslove u okviru Sekretarijata Veća, u skladu sa važećim pravnim okvirom koji reguliše

rregullon administratën e Sistemit Prokurorial dhe dispozitat përkatëse për marrëdhënien e punës.	framework regulating the administration of the prosecutorial system and the relevant provisions governing employment relations.	administraciju tužilačkog sistema i relevantnim odredbama o radnim odnosima.
Neni 16 **Hyrja në fuqi**	**Article 16** **Entry into force**	**Član 16** **Stupanje na snagu**
Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas publikimit në Gazetën Zyrtare.	This Law shall enter into force fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette.	Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od objavljivanja u Službenom Listu
Albulena Haxhiu _____ Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës	**Albulena Haxhiu** _____ Speaker of the Assembly of the Republic of Kosovo	**Albulena Haxhiu** _____ Predsednica Skupštine Republike Kosova